



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Podujevë, 30 tetor 2019

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja c), 17 shkronja f), dhe 40.2 shkronjat a), g) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, neneve 8 shkronja a), 15 shkronja f), dhe 19.1 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal nr.03/L-049, dispozitave të neneve 15 dhe 34 të Ligjit për Mbeturina nr.04/L-060, dhe neneve 14, 15 parag. 2.3, 11 parag. 1.11, dhe 34 parag. 2.1, 2.7, të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 30 tetor 2019, miratoi,

RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Qëllimi

Neni 1

Kjo rregullore ka për qëllim që të rregulloj çështjen e menaxhimit të mbeturinave komunale, në funksion të krijimit të një sistem i qëndrueshëm mbi menaxhimin e mbeturinave.

Fushëveprimi

Neni 2

Kjo Rregullore definoi kushtet për menaxhimin e integruar të mbeturinave (zvogëlimin e sasisë së deponuar, ndarjen, shkarkimin, grumbullimin, transportimin, deponimin dhe aktivitetet e riciklimit) me qëllim të mbrojtjes së mjedisit jetësor në territorin e Komunës së Podujevës.

Përkufizimet

Neni 3

Mbeturina: substancë apo objekt që prodhuesi apo zotëruesi e hedh, ka për qëllim ta hedh apo është i detyruar ta hedh.

MM: (më tutje i referohemi MM), aktivitetet për evitimin dhe reduktimin e prodhimit të mbeturinave dhe ndikimit të tyre në mjedis dhe shëndetin e njeriut, mbledhjen, transportin, trajtimin, ripërdorimin, përpunimin, riciklimin dhe deponimin përfundimtar të mbeturinës, përfshirë monitorimin dhe kujdesin edhe pas kryerjes së këtyre aktiviteteve.

Operatori: personi juridik i cili në përputhje me dispozitat e ligjit menaxhon, kontrollon, është përgjegjës për objektet dhe pajisjet e mbeturinave dhe është i autorizuar të marrë vendime në lidhje me funksionet ekonomike ose teknike të pajisjeve dhe objekteve.

Licenca për menaxhimin e mbeturinave: leje me shkrim e cila lëshohet me vendim të Ministrisë, me të cilën vërtetohet se janë plotësuar kushtet sipas Ligjeve në fuqi.

Person: person fizik ose juridik i cili është i involvuar në mënyrë të drejtpërdrejt ose tërthorazi, në proceset për menaxhimin e mbeturinave.

Konsumatori: personi i cili ka lidhur kontratë për shërbime me ofruesin e shërbimeve ose merr shërbime të caktuara

Ri-përdorimi: çfarëdo operimi me të cilin çdo produkt apo komponent e cila nuk është mbeturinë dhe përdoret përsëri për të njëjtin qëllim për të cilin janë destinuar

Mbledhja: mbledhje dhe transportim i mbeturinave duke përfshirë klasifikimin paraprak në lloje dhe magazinimin e mbeturinave për qëllime të bartjes deri në objekti për trajtim ose deponim të mbeturinave.

Mbledhja e ndarë: nënkupton mbledhjen, kur grumbullimi i mbeturinave bëhet në mënyrë të ndarë në lloje, të klasifikuar sipas natyrës dhe pajisjeve për të lehtësuar trajtimin specifik.

Prodhuesi i mbeturinës: çdo person, veprimtaria e të cilit krijon/prodhon mbeturinë ose çdonjëri që merret me para-procesim, përzierje apo operime tjera që rezultojnë në ndryshimin e natyrës apo përbërjen e mbeturinës.

Zotëruesi i mbeturinës: prodhuesi i mbeturinës apo personi që e posedon mbeturinën.

Mbeturina komunale: mbeturina nga amvisëritë, dhe mbeturina nga aktivitetet tjera të cilat për shkak të përbërjes dhe natyrës së tyre, janë të ngjashme me ato të amvisërisë.

Mbeturina e parrezikshme: mbeturinat që nuk paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut dhe që nuk posedojnë karakteristika të mbeturinave të rrezikshme

Mbeturina komerciale: mbeturinat të cilat vijnë nga objektet që përdoren për qëllimet e tregut ose biznesit, sportit, edukimit, rekreacionit, por nuk përfshihen mbeturinat industriale

Mbeturina inerte: mbeturinat të cilat nuk pësojnë ndonjë ndryshim të rëndësishëm fizik, kimik dhe biologjik në vendet ku janë deponuar si:

Mbeturina inerte: që nuk treten, nuk ndizen ose nuk reagojnë fizikisht apo kimikisht, nuk zbërthehen biologjikisht në kontakt me materiet tjera dhe nuk ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

I tërë kullimi dhe përmbajtja ndotëse e mbeturinës: mbetjet ekotoksike duhet të jenë të vlerës së papërfillshme dhe të mos rrezikojnë cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Mbeturinë e vëllimshme: mbeturinat me përmasa të mëdha fizike nga pajisjet dhe makineritë, grumbullimi, transportimi dhe largimi i të cilave bëhet në mënyrë të veçantë.

Qendrat grumbulluese: Lokacioni për grumbullimin e mbeturinave të ndara sipas llojeve të përcaktuara.

3R: reduktim, ripërdorim, reciklim

Mbledhja, grumbullimi dhe transportimi i mbeturinave

Neni 4

1. Grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave e bënë personi juridik i licencuar dhe i kontraktuar nga komuna, i cili mbledh, grumbullon dhe transporton mbeturinat prej gjeneruesit e deri në deponinë e mbeturinave apo në vendet e licencuara për riciklim.

2. Mbeturinat e rrezikshme, paraprakisht klasifikohen sipas llojeve, mbledhen, grumbullohen dhe transportohen.

3. Nëse ndotja ndodh gjatë transportimit të mbeturinave, transportuesi është i detyruar që vendin e ndotur ta kthejë në gjendjen e më mëparshme.

Përgjegjësitë e komunës mbi menaxhimin e mbeturinave

Neni 5

1. Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm mbi menaxhimin e mbeturinave komunale.
2. Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm financiar.
3. Procesi i kontraktimit për shërbimet e menaxhimit të mbeturinave.
4. Formimi i sektorit mbi menaxhimin e mbeturinave dhe mbrojtë të mjedisit. Sektori mbi menaxhimin e mbeturinave, monitoron dhe udhëzon ofruesit e shërbimeve për grumbullimin, transportimin dhe deponimin e mbeturinave.
6. Identifikimi pikat ilegale (të zeza) të mbeturinave dhe evitimin e tyre.
7. Përcaktimi i lokacioneve, numrin dhe llojin e kontejnerëve në bashkëpunim me operatorin ose palët e treta.
8. Promovimi i zvogëlimit të sasisë së mbeturinave (3R, kompostimit shtëpiak etj.)
9. Promovimi i ngritjes së vetëdijesimit publik, pjesëmarrja aktive e qytetarëve në implementimin e menaxhimit të mbeturinave.
10. Planifikimin buxhetor mbi funksionimin e menaxhimit të mbeturinave.
11. Faturimi i taksës për mbeturinat, organizimi dhe shpërndarja.
12. Përpilimi i raporteve për menaxhimin e mbeturinave:
 - 12.1. Faturimi
 - 13.2. Shkalla e inkasimit
 - 13.3. Sasinë e grumbulluar dhe të deponuar të mbeturinave
13. Shqyrtimi ankesave dhe parashtrësive të taksapaguesve për mbeturina
14. Përcaktimi i taksës dhe mënyra e arkëtimit të mjeteve financiare
15. Dorëzimi i Raportit në Ministrin e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor, për menaxhim të mbeturinave, më së largu 31 mars të vitit pasues.
16. Sigurimi i kushte të veprimit dhe operimi për operatorët.

Të drejtat dhe detyrat e gjeneruesve të mbeturinave

Neni 6

1. Çdo gjenerues i mbeturinave është i obliguar të përfshihet në sistemin e menaxhimit të mbeturinave.
2. Çdo gjenerues i mbeturinave ka të drejtë ankese për shërbimin e ofruar.
3. Çdo gjenerues i mbeturinave duhet të respektoj rregullat dhe orarin e shkarkimit të shportave dhe kontejnerë adekuat, të përcaktuar sipas Planit lokal të menaxhimit të mbeturinave.
4. Çdo gjenerues duhet të bëjë përpjekje për zvogëlimin e sasisë së mbeturinave përmes kompostimit dhe formave tjera të lejueshme.
5. Çdo gjenerues i mbeturinave duhet që të paraqes ndryshimin e të dhënave (si p.sh. shitja e pronës, trashëgimia, dëshmitë dhe dokumentet tjera të përditësuara).
6. Regjistrimet e reja të amvisërive në databazë behën në bazë të këtyre kushteve;
 - 6.1. Kontrata e shitblerjes, qirasë;
 - 6.1.1. Blerësi regjistrohet në databazë, nëse nuk është i regjistruar paraprakisht nga data e nënshkrimit të kontratës, derisa shitësit i ndryshohet vetëm adresa.
 - 6.2. Regjistrimi i njehsorit të rrymës elektrike
 - 6.3. Konfirmimi i pagesës së faturës për mbeturina në vendbanimin paraprak
 - 6.4. Dokumenti identifikues

7. Për shërbimin e ofruar, gjeneruesi obligohet të paguaj taksën e shërbimit.
8. Çdo gjenerues, duhet të bashkëpunoj me autoritetin përgjegjës, për të siguruar një mjedis të pastër.
9. Të gjithë gjeneruesit e mbeturinave janë të obliguar të regjistrohen në listat e shërbimit të konsumatorëve për mbledhje dhe bartjen e mbeturinave.
10. Gjeneruesit e mbeturinave detyrohen që mbeturinat t'i ndajnë dhe t'i vendosin sipas sistemit të përcaktuar nga komuna.
11. Ndërmarrjet prodhuese, ndërtuese dhe tjera të cilat gjenerojnë mbeturina, obligohen që Komunës së Podujevës t'ia dorëzojnë planin e menaxhimit të mbeturinave, të cilat i gjenerojnë gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

Taksa mbi mbeturinat

Neni 7

1. Taksa për mbeturinat, faturohet dhe arkëtohet nga Komuna.
2. Faturimi për mbeturina bëhet bazuar ne sistemin e të dhënave, kurse fatura i dorëzohet gjeneruesit çdo tremujor.
3. Gjeneruesi i mbeturinave obligohet që të paguaj faturën e taksës së mbeturinave, për çdo muaj të vitit ose me këste si më poshtë:
 - 3.1. Kësti i parë janar – mars
 - 3.2. Kësti i dytë prill – qershor
 - 3.3. Kësti i tretë korrik- shtator
 - 3.4. Kësti i katërt tetor – dhjetor.
4. Banorët jo-rezidentë që bëjnë shpenzime të energjisë elektrike deri në tre (3) muaj brenda vitit ngarkohen me tarifë 14,10 €/vit, të dëshmuar me gjendjen për vitin përkatës.
5. Çdo gjenerues që banon me qira është i obliguar të bëjë pagesën për mbeturina në emër të vet, ose ne emër të pronarit të ligjshëm (në bazë të kontratës për qiradhënie).
6. Nëse Gjeneruesi i mbeturinave nuk e paguan këstin e fundit, nuk do të merr shërbime komunale administrative në:
 - 6.1. Drejtorinë e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë
 - 6.2. Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit
 - 6.3. Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
 - 6.4. Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik
 - 6.5. Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave
 - 6.6. Drejtorinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
si dhe nga Drejtoritë të tjera, me përjashtim të sektorit të regjistrimit civil.
7. Taksa mujore për mbeturina kategorizohet si më poshtë:
 - 7.1. Konsumatorët e amvisërive:
 - 7.1.1. Rezident
 - 7.1.2. Jo Rezident
 - i. Të shërbyer përmes kontejnerëve të përbashkët
 - ii. Të shërbyer me shërbimin derë më derë
 - 7.2. Konsumatorët komercial / industrial:
 - 7.2.1. Dyqanet e vogla zejtare dhe shërbyese
 - 7.2.2. Subjekte të mesme deri në ato të mëdha komerciale me kosto të ulët të shërbimit
 - 7.2.3. Subjekte të mesme deri në ato të mëdha komerciale me kosto të lartë të shërbimit,

me kontratë të veçantë;

7.3. Institucionet:

7.3.1. Gjeneruesit e vegjël institucionalë;

7.3.2. Gjeneruesit e mesëm dhe të mëdhenj institucionalë;

7.3.3. Gjeneruesit e mëdhenj institucional të shërbyer me kontratë;

8. Detajizimi i mëtejshëm i kategorizimit dhe taksave gjendet në Shtojcën I të kësaj Rregulloreje.

9. Shkalla e taksës do të rishikohet sipas nevojës nga Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimi, miratohet nga Kuvendi Komunal duke marrë parasysh koston e shërbimit.

10. Nëse Kuvendi Komunal aprovon shkallën tjetër të arkëtimit të propozuar për vitin në vijim, qytetarët njoftohen para vitit të ardhshëm fiskal.

Detyrat dhe Përgjegjësit e Operatorëve të kontraktuar për menaxhimin e mbeturinave

Neni 8

1. Operatori i kontraktuar nga organi kontraktues, për ofrimin e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave, obligohet që të veproj sipas kësaj Rregulloreje, kontratës dhe ligjeve në fuqi.

2. Operatorët janë të obliguar, në qoftë se kërkohet, largimin e mbeturinave të cilat konstatohen se nuk janë mbeturina shtëpiake, t'i marrë me kompensim të veçantë për hedhjen e tyre në vendin e dedikuar.

3. Operatorët janë të obliguar për punët e mirëmbajtjes duhet t'i pastrojnë edhe hapësirat rreth kontejnerëve me rastin e zbrazjes dhe në çdo kohë të jenë në gjendje të pastër.

4. Me qëllim të mirëmbajtjes më të mirë të gjendjes së pastërtisë në vendet publike vendosen shportat e mbeturinave, për të cilat kujdeset kompania përkatëse, nëse është e specifikuar me kontratë.

5. Operoret janë të obliguar që t'i përmbahet orarit për grumbullim të mbeturinave në lagjet apo fshatrat e Komunës së Podujevës, po ashtu edhe qytetarët janë të obliguar që t'i përmbahen orarit të përcaktuar nga Kompania.

Veprimet e ndaluara

Neni 9

1. Me këtë rregullore ndalohen veprimet si më poshtë:

1.1. Hedhja e mbeturinave ndërtimore në rrugë, trotuare, sheshe apo mjedise publike;

1.2. Hedhja e mbeturinave të llojeve tjera në kontejnerë ose në pikat mbledhëse të mbeturinave, të cilat nuk ndahen ashtu siç është paraparë me këtë rregullore;

1.3. Hedhja e mbeturinave në hapësirat e përbashkëta brenda dhe jashtë objekteve të banimit kolektiv (ballkonet, korridoret, tarracat e banesave etj.);

1.4. Përzierja dhe hedhja e mbeturinave jashtë kontejnerëve të destinuar për ndarjen e mbeturinave të riciklueshme;

1.5. Hedhja e mbeturinave në rrugë nga automjetet në lëvizje;

1.6. Hedhja dhe deponimi i mbeturinave në hapësirat publike (në rrugë, parqe, dhe në vende të tjera publike);

1.7. Ndërrimi i vendndodhjes së kontejnerëve, pikave ose vendeve të betonuara për hedhjen e mbeturinave pa autorizim të autoriteteve komunale;

- 1.8. Djegia e mbeturinave në vende publike, kontejnerë, ose në pikat mbledhëse ose ndarëse të mbeturinave;
- 1.9. Shfrytëzimi i mbeturinave si ushqim për kafshët apo të ngjashme nga kontejnerët ose nga pikat mbledhëse të mbeturinave;
- 1.10. Shfrytëzimi i kontejnerëve publik nga bizneset, veprimtaritë ekonomike për llojet e mbeturinave që nuk përfshihen në përkufizimin “mbeturina komunale dhe komerciale”
- 1.11. Gërmimi, përzierja, derdhja dhe përhapja e mbeturinave të hedhura në kontejnerë, ose në pikat mbledhëse nga personat e paautorizuar;
- 1.12. Hedhja e mbeturinave jashtë kontejnerëve dhe shportave;
- 1.13. Derdhja apo rrjedhja e mbeturinave prej automjeteve gjatë transportimit për në impiantet për trajtim apo për deponim në deponi të mbeturinave;
- 1.14. Transportuesit duhet të marrin masa që gjatë transportimit të mbeturinave, automjetet e tyre të kenë mbulesë adekuate, me qëllim të pengimit të derdhjes, shpërndarjes apo rrjedhjes së mbeturinave gjatë transportit, me destinacion tek impiantet për trajtim apo në deponi të mbeturinave;
- 1.15. Ndryshimi i mënyrës, metodave, teknikës dhe teknologjisë së largimit të mbeturinave në kundërshtim me kushtet e përcaktuara me kontratë, apo ndonjë formë tjetër.
- 1.16. Mbeturinat nga pajisjet elektrike, elektronike dhe të vëllimshme nuk guxojnë të hedhen në kontejnerë të mbeturinave ose në afërsi të tyre.
- 1.17. Të gjitha ndërmarrjet hoteliere, mishtoret, blektorët dhe personat fizik obligohen që eshtrat e kafshëve të therura t’i vendosin në kontejnerë të caktuar. Ndërmarrja përkatëse e kontraktuar nga Komuna është e obliguar që këto mbeturina t’i dërgojnë në varreza përkatëse. Pronarët e fermave, personat fizik janë të obliguar që kafshët e ngordhura t’i lajmërojnë brenda 12 orëve pas kohës së ngordhjes së kafshëve për bartjen e tyre në vende të caktuar, me shpenzime vetanake.
- 1.18. Mbeturinat të cilat nuk i takojnë mbeturinave shtëpiake (mbeturinat e rrezikshme) mbahen deri në bartjen e tyre nëpër enë speciale në objektet, respektivisht në vendet e caktuara për to.
- 1.19. Hedhja e mbeturinave dhe materialeve tjera fundrrinore në shtratin e lumenjve, përrenjve, kanaleve, në rrugë dhe sipërfaqeve të tjera publike;
- 1.20. Hedhja dhe vendosja e plehut të kafshëve në sipërfaqet jashtë oborreve si dhe në pronën e tyre, në vendet ku distanca nuk është e mjaftueshme nga vendet e banuara me popullatë njerëzore;
- 1.21. Përdorimi i puseve të braktisura për t’i deponuar mbeturinat;
- 1.22. Hedhja e vajrave motorike dhe derivateve të naftës në të gjitha vendet publike, përveç vendeve të caktuara nga organet kompetente;
- 1.23. Hedhja e mbeturinave ndërtimore në vendet publike, përveç vendeve të përcaktuara nga organet kompetente;
- 1.24. Bartja e mbeturinave dhe fekaleve me mjete që nuk janë të destinuara dhe të licencuara për bartje të tyre;
- 1.25. Mbajtja e mbeturinave në kosha të cilat nuk i plotësojnë kushtet për mbajtjen e tyre;
- 1.26. Ndezja e zjarreve prej mbeturinave dhe materialeve të tjera që ndotin ajrin dhe mjedisin në përgjithësi;

1.27. Kompanitë janë të obliguara, që pas kryerjes së punimeve, t'i largojnë mbeturinat nga vend punishtja dhe deponimi i tyre të bëhet në deponi të licencuar.

1.28. Hedhja e mbeturinave në kontejner të lagjeve tjera.

Dispozitat Ndëshkuese

Neni 10

1. Ndaj gjeneruesit të mbeturinave i cili nuk e bën pagesën e taksës për mbeturina dhe i cili nuk i përmbahet rregullave të shkarkimit, të përcaktuara sipas planit të menaxhimit të mbeturinave do të iniciohet procedurë sipas ligjeve në fuqi.

2. Për shkelësit e dispozitave të kësaj rregulloreje, për veprimet e ndaluara, neni 9, (paragrafët 1 deri 35) inspektori komunal, zyrtari policor, shqipton gjobë mandatore sipas Udhëzimit Administrativ 14/2015, apo gjobat tjera të përcaktuara sipas Ligjit për mbeturina (Nenet 70 - 75).

Dispozitat Kalimtare dhe Përfundimtare

Neni 11

1. Në të gjitha rastet që nuk janë të rregulluara me këtë Rregullore, do të zbatohen dispozitat e Ligjeve në fuqi

2. Zbatimin e kësaj rregulloreje, nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komunës, e bëjnë, Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe njësitë përkatëse të administratës komunale.

3. Mbikëqyrjen inspektuese për zbatimin e dispozitave të kësaj rregulloreje e bën Drejtoria e Inspeksionit, dhe zyrtarët e tjerë të autorizuar nga ana e Komunës.

Hyrja në fuqi

Neni 12

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës dhe në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, përkatësisht konform nenit 81 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

2. Zbatimi i kësaj Rregulloreje fillon nga data 01 qershor 2020.

3. Me fillimin e zbatimit të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Podujevës me nr.prot.01-006-16407 e datës 04 shkurt 2015.

Nr.01-352/11-0084561/19

**Podujevë,
30 tetor 2019**



Kryesuesi i Kuvendit

Fatmir Gashi

Kategorizimi i Konsumatorëve Komercial/Industrial

Shërbimet e ofruara me kontejnerë të përbashkët

Nënkategoria 1 'Veprimtaritë e vogla zejtare dhe shërbyese'	Nënkategoria 2 'Subjektet e mesme deri të mëdha komerciale/industriale me kosto të ulët të shërbimit'	Nënkategoria 3 Subjektet e mesme deri të mëdha komerciale/industriale me kosto të moderuar të shërbimit	Nënkategoria 4 'Konsumatorët me kontrata të veqanta për zbrazje'
Kioska, kafe pjekëse, shitës të CD-ve dhe kasetave, argjendari, orëtar, agjenci turistike, avokatura, videolojëra, video klube, internet kafe, rrobaqepës, këpuçtarë, dyqane fotografish, pastrim kimik, kozmetika, optika, gurgdhendës, saraç-mbathtarë, zyra e inkasimit, OJQ-te, shitore suvenirësh, këmbimore, autoparkime, butiqe, librari, llamarine punues, axhustator dhe veprimtari të ngjashme	auto larje, kurse të gjuhëve dhe IT- së, frizer meshkujsh dhe femrash, ëmbëltore, shitore tekstili, shitore të auto-pjesëve, hekurishte, shitore sanitare, shitore të mobileve, shitore këpuçësh, servise të ndryshme (elektroteknike dhe TI), objekte fetare, zyra të partive politike, farmaci, zyra postare, bastore, ordianca private, ordianca stomatologjike, automekanike, autoelektriste, autosaldues, autosallone dhe veprimtari të ngjashme	furra te bukes. furra të bukës dhe byrektore, kafeteri, shitore ushqimore, podrume të pijeve, poliklinika, filiala të bankave, sallone të sanitarisë, sallone mobiliesh, qendra sportive, qendra te fitnesit, fastfood, pompa te benzines, xhamapreres, gjellëtore, restorante, fastfood-restorante, diskoteka, motele, pompa te benzines me restorante dhe veprimtari te ngjashme	stadione, qendra tregtare, fusha te sportit dhe konsumatorët e nenkategorise 4 me sasi te medha te mbeturinave te gjeneruara

	Urban			Rural		
	Tarifat aktuale	Tarifat e propozuara	Ngritje % (Zbritje)	Tarifat aktuale	Tarifat e propozuara	Ngritje % (Zbritje)
I. Amvsëritë						
Amvisëritë	4.35	4.35	0.0%	4.35	4.35	0.0%
II. Komercial/industrial						
Dyqanet e vogla dhe artizanale	7.03	7.03	0.0%	5.03	5.03	0.0%
Bizneset e mesme deri të mëdha me kosto të ulët të shërbimit	10.06	10.06	0.0%	6.03	6.03	0.0%
Bizneset e mesme deri të mëdha me kosto të moderuar të shërbimit	17.22	17.22	0.0%	11.50	11.50	0.0%
Bizneset e mesme deri të mëdha me kosto të lartë të shërbimit	17.22	17.22	0.0%	11.50	11.50	0.0%
<i>Bizneset me kontratë - 1.1 m3</i>	9.74	9.74	0.0%	9.74	9.74	0.0%
<i>Bizneset me kontratë - 5.1 m3</i>			0.0%			0.0%
<i>Bizneset me kontratë - 7.1 m3</i>	37.80	37.80	0.0%	37.80	37.80	0.0%
III. Institucionet						
<i>Institucionet me kontratë - 1.1 m3</i>	9.74	9.74	0.0%	9.74	9.74	0.0%
<i>Institucionet me kontratë - 5.1 m3</i>			0.0%			0.0%
<i>Institucionet me kontratë - 7.1 m3</i>	37.80	37.80	0.0%	37.80	37.80	0.0%



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja c), 17 shkronja f), dhe 40.2 shkronjat a), g) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, neneve 8 shkronja a), 15 shkronja f), dhe 19.1 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal nr.03/L-049, dispozitave të neneve 15 dhe 34 të Ligjit për Mbeturina nr.04/L-060, nenit 12 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës, dhe neneve 14, 15 parag. 2.3, 11 parag. 1.11, dhe 34 parag. 2.1, 2.7, të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 22 maj 2020, miratoi,

RREGULLORE PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Neni 12 paragrafi 2 i Rregullores nr.prot.01-352/11-0084561/19 të datës 30 tetor 2019 për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Podujevës, ku thuhet;

“Zbatimi i kësaj Rregulloreje fillon nga data 01 qershor 2020”,

Ndryshohet, si vijon;

Zbatimi i kësaj Rregulloreje fillon nga data 01 qershor 2021

Neni 2

Kjo Rregullore hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqe zyrtare të Komunës, si dhe në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Nr.01-352/04-0023112/20
Podujevë,
22 maj 2020



Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja c), 17 shkronja f), dhe 40.2 shkronjat a), g) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, neneve 8 shkronja a), 15 shkronja f), dhe 19.1 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal nr.03/L-049, dispozitave të neneve 15 dhe 34 të Ligjit për Mbeturina nr.04/L-060, nenit 12 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës, dhe neneve 14, 15 parag. 2.3, 11 parag. 1.11, dhe 34 parag. 2.1, 2.7, të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 04 qershor 2021, miratoi këtë,

RREGULLORE PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Ndryshohet dhe plotësohet Rregullorja nr.prot.01-352/11-0084561/19 për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Podujevës e datës 30 tetor 2019, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren nr.prot.01-352/04-0023112/20 të datës 22 maj 2020, dhe atë si në vijim;

Neni 12 paragrafi 2 i Rregullores nr.prot.01-352/11-0084561/19 të datës 30 tetor 2019 për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Podujevës, ku thuhet;

“Zbatimi i kësaj Rregulloreje fillon nga data 01 qershor 2021”,

Ndryshohet, si vijon;

Zbatimi i kësaj Rregulloreje fillon nga data 01 korrik 2022

Neni 2

Kjo Rregullore hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqe zyrtare të Komunës, si dhe në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Nr.01-352/11-0045227/21
Podujevë,
04 qershor 2021



Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi